

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Në Tiranë, sot me datë 28 Mars 2024 në selinë e shoqërisë “ **NATIONAL CONSTRUCTION**” sh.p.k, me adresë në Tiranë Autostrada Tirane-Durres, Km.15, Godina Delta, Zona Kadastrale 2679,nr.Pasurie 34/86, palët si më poshtë hartuan këtë kontratë shitje:

SHITËSI:

Shoqëria DEUTSCHCOLOR, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L21326504J, me adresë Autostrada Tiranë - Durrës, Zonë Kadastrale 3796, **përfaqësuar nga Aksionari i vetëm Luan Muça**, atësia Shahin, lindur në Elbasan dhe banues në adresë Vilave; Tiranë, lindur më 05/08/1971, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038371587 dhe nr. personal H10805062A, përfaqësuar me prokurë të posacme me nr.1147 Rep dhe 324 Kol, datë 28.03.2024, nga **Ermira Varvarica**, atësia Muhamet, amësia Zizë, shtetas Shqiptar, lindur në Tropojë dhe banues në TIRANË, me adresë Rr. e Dibrës; Tiranë, lindur më 24/09/1979, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 032864364 dhe nr. personal H95924102U

BLERËSI:

Shoqëria “TDT & PARTNERS” sh.p.k, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L61814005P, me adresë Njesia Bashkiake Nr 2, Rruga Deshmoret E Kombit, Kullat Binjake Nr 1, Kati 12, Ap 12/1, përfaqësuar nga Administratori Sali Peka, atësia Rexhep, amësia Sanie, shtetas Shqiptar, lindur në Krume, Kukës dhe banues në TIRANË, me adresë Xhanfize Keko; Nd. 83; H. 13; Ap. 9; Njësia Administrative Nr. 4; Njësia Bashkiake Nr. 4; 1005; Tiranë, lindur më 17/04/1983, gjendja civile “I martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034186729 dhe nr. personal I30417035I.

Palët e mësipërme kryen redaktimin e kësaj kontrate shitje kuotash në vazhdim:

Shitësi Shoqëria “**DEUTSCHCOLOR**” sh.a është zotërues i l(një) kuote që përfaqeson 100 % të kapitalit të shoqërisë “**NATIONAL CONSTRUCTION**” sh.p.k., e cila është një shoqëri tregtare shqiptare , e regjistruar pranë QKB-së, me datë 16/01/2024, me NIPT M41323031K.

Kapitali i shoqërisë është në shumën 10,370,000 lekë, i zotëruar nga ortaku i vetëm, si me poshtë:
Shoqëria “DEUTSCHCOLOR” sh.a l (një) kuote 100 % per shumën 10,370,000 lekë .

Objekti i kontratës

Asambleja e ortakut të vetëm të shoqërisë me vendimin e datës 27.03.2024, bazuar në Ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", i ndryshuar, Statutin e Shoqërisë, etj., ka vendosur:

Shitjen e 50% të kapitalit të zotëruar në shoqëri nga ortakut **DEUTCHCOLOR" sh.a**, blerësit **Shoqërisë "TDT & PARTNERS" sh.p.k**

Me këtë kontratë shitje bëhen ndryshimet si më poshtë:

- **DEUTCHCOLOR" sh.a, ishte**, ortak i vetëm i shoqërisë dhe zotëruar i 1(nje) kuote, që përfaqëson 100% të kapitalit me vlerë 10,370,000 lekë ;
- **Shoqëria "TDT & PARTNERS" sh.p.k, bëhet**, ortak e shoqërisë dhe zotëruar e 1 (një) kuote, që përfaqëson 50% të kapitalit me vlerë **5.185.000 leke** dhe
- **Shoqëria "DEUTCHCOLOR" sh.a, bëhet**, ortak e shoqërisë dhe zotëruar e 1(nje) kuote, që përfaqëson 50% të kapitalit me vlerë **5.185.000 lekë**.

Çmimi i shitjes

- Çmimi i shitjes së kuotave, që përfaqëson 50 % të kapitalit të zotëruar nga ortakut **DEUTSCHCOLOR" sh.a**, që transferohet nëpërmjet kësaj kontrate shitje në favor të blerësit **TDT & PARTNERS" sh.p.k** është **5.185.000 (pesë milion e njëqind e tetëdhjet e pesë mije) leke**.

Blerësi në marrëveshje me shitësin, deklarojnë se dokumentimi i likuidimit të vlerës së plotë, bëhet vetëm nëpërmjet llogarisë bankare dhe palët nuk kanë asnjë pretendim tjetër. Kalimi i pronësisë së kuotave bëhet menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate nga shitësi në favor të blerësit.

Garancitë

Shitësi deklaron dhe garanton se është i vetmi titullar i ligjshëm i kuotave që po transferohen. nëpërmjet kësaj kontrate dhe se ajo është e lirë nga çdo barrë apo pretendim tjetër ligjor.

Heqje dorë nga të drejtat dhe detyrimet

Shitësi deklaron nën përgjegjësinë e tij personale se heq dorë nga të gjitha të drejtat që i takojnë mbi kuotat që po e transferon nëpërmjet kësaj kontrate shitje në favor të Blerësit TDT& PARTNERS , e cila bëhet pronare e ligjshëm e kësaj kuote.

Kjo kontratë u hartua në 3 kopje me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe dhe palët pasi e lexuan, e kuptuan, deklaruan se janë dakort me sa më sipër, dhe e nënshkruan rregullisht.

SHITËSI

DEUTSCHCOLOR

AKSIONER

LUAN MUÇA

Përfaqësuar me prokurë nga Ermira Varvarica

Ermira Varvarica



BLERËSI

Shoqëria "TDT & PARTNERS"

ADMINISTRATOR

SALI PEKA

